



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 16.12.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9918 , DATË 19.5.2008, “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në mbledhjen e tij të datës 10 dhe 16 dhjetor 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zonjën Eglantina Gjermani.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të Autoritetit të Mediave Audiovizive, si dhe të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj ka si qëllim të reflektojë në legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike ndryshimet e propozuara në legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive, në lidhje me rregullimin e shërbimeve të publikimeve elektronike.

Ndryshimet e propozuara në legjislacionin për mediat audiovizive vijnë për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, kulturor, ekonomik dhe politik të shoqërisë shqiptare, një fenomen që haset gjerësisht edhe në vendet e tjera, por ndërkohë lind nevoja për ndërhyrje edhe në ligjin për komunikimet elektronike pasi AKEP-i është organi i vetëm rregullator që administron domain nën.al.

Kuadri ekzistues ligjor në fuqi nuk parashikon asnjë rregullim për veprimtarinë e subjekteve të ndryshme që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet portaleve online, si dhe nuk parashikon në mënyrë shteruese nivelin e koordinimit midis institucioneve përgjegjëse dhe sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik.

Mosrregullimi shterrues lidhur me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të publikimeve online/elektronike si për poseduesit të domain nën .al dhe për ata jashtë regjimit të domaineve nën.al, ka sjellë probleme lidhur me administrimin rigoroz të veprimtarisë elektronike, si dhe nuk legjitimon ndërhyrjen e institucioneve përgjegjëse në rregullimin e veprimtarisë elektronike të subjekteve, të cilat nuk ndodhen në regjimin e Domain nën.al por që ushtrojnë aktivitet tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat kryesore të këtij projektligji janë si më poshtë:

- Të rregullohet koordinimi midis institucioneve përgjegjëse dhe sipërmarrësve dhe ofruesve të shërbimeve të publikimeve online;
- Të normohet veprimtaria e shërbimeve të publikimeve elektronike;

Rregullimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike, si dhe të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik, përmes një kornize ligjore ka si qëllim arritjen e një ekuilibri ndërmjet qasjes në shërbimet e përmbajtjes online, mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencës, garantimin e të drejtave të njeriut, respektimin e të drejtave të autorit, si dhe respektimin apo sigurimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme.

AKEP-ja në bashkëpunim dhe koordinim me AMA-n do të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore kundrejt të gjithë sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të poseduesve të domain nën al. me qëllim zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave pranë AMA-s lidhur me respektimin e kufizimeve lidhur me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 5 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përafron ndonjë pjesë të legjislacionit të Bashkimit European.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Projektligji nuk shoqërohet me ndikim ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi AKEP është organ publik i pavarur, i cili nuk financohet nga buxheti i shtetit. Të gjitha sistemet elektronike janë të ngritura pranë AKEP-it, dhe stafi është i kualifikuar për të përballuar funksionet e atribuara me ndryshimet përkatëse ligjore që priten të miratohen.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që projektligji reflekton ndryshimet e propozuara në legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesor që ky projektligj sjell, dhe lidhjen e tij me ndryshimet e propozuara në legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në çështjet që lidhen me konsultimin me grupet e interesit; rishikimin e gjobave në mënyrë që të jenë në linjë me ato që vendosen nga AMA dhe jo ato që vendos AKEP për sipërmarrësit në fushën e komunikimeve elektronike; zbatimin nga AKEP të vendimeve që do të merren nga Këshilli i Ankesave në AMA; etj.

- ***Ndryshime të projektligjit***

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni u njoh me raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Mjetet e Informimit Publik dhe Edukimit dhe vërejtjet e paraqitura në to, të cilat i bën pjesë të vërejtjeve të tij si më poshtë:

1. Neni 2 të riformulohet si më poshtë:

Neni 2

Në nenin 8, shkronja “k” të riformulohet si më poshtë:

k) administron *domain cc.TLD.al*, *nëndomainet e tij*, si dhe përcakton me rregullore të posaçme rregulla të hollësishme për metodologjinë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.”.

2. Neni 4 të riformulohet si më poshtë:

“Neni 4

Në nenin 137, në fund të kreut V, pas pikës 19 shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:

“20. Nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP-it, që lidhen me zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA-s apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4, të këtij ligji.”.

- ***Përfundime***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Eglantina GJERMENI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar